



AGENCIA PROTIV KORUPCIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Lep. Dep. Dep.	D.P
Nr. l. faq Broj. stranica	01
Nr. Prot. Bi Prot. Prot. No.	03-4593/17
Uta Datum	24.11.2011

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

Regj.nr.6-10327/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE- PEJË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lytfi Radoniqi nga Peja, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7 par. 1 lidhur me nenin 16 par 1, pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në bazë të nenit 198, par 1, pika 2, lidhur me nenin 37, 123 e 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 21.11.2011 merr këtë :

AKTVENDIM

- **PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit **LYTFI / JUSUF/ RADONIQI**, lindur më 01.09.1957 në Pejë, ku edhe banon, Rr."Jusuf Kelmendi", nr 1, me profesion ekonomist, zyrtar në ATK-ë, zyra regionale në Pejë, Anëtar I Bordit në Kompanim Rajonale të Mbeturinave 'Ambienti' SH.A- Pejë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës, nga se ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësin kundërvajtëse të të njëjtit.

-Shpenzimet e procedurale bien në barrë të kësaj gjykate

-Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet palëve

Arsyetim

Agjensioni Kundër Korrupsion në Prishtinë, ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse 01-3189/11 e dt. 14.07.2011, kundër të pandehurit, me shënime si në dispozitiv, për shkak se s anëtar i bordit në KRM „Ambienti,, në Pejë, me rastin e marrjes së detyrës, e si zyrtar i lartë publik nuk e ka bërë deklarinin e pasurisë ,në afatin prej 60 /gjashtëdhjetë/ ditësh, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari pasi filloi procedurën kundërvajtëse për vërtetimin e gjendjes faktike morri në pyetje të pandehurin, i cili në mbrojtjen e tij deklaroi se është e vërtet që nuk e ka deklaruar me kohë pasurin, si zyrtar i lartë, meqenëse është anëtar i Bordit i SH.A Ambienti në Pejë, ku është emëruar me dt.01.03.11, por shton se nuk ka qenë i informuar as prej Agjensionit e as prej Menagjerit të Kompanisë, për këtë obligim.


Pas konsultimit me zyrtarët e AKK-ës, nga të njëjtit Gjykata është informuar edhe nëpërmjet postës elektronike se përgjegjës për informimin e Anëtarëve të Bordit është Menagjeri i Kompanisë dhe se i njëjti është informuar dhe ju kanë dërguar formularët me kohë për anëtarët e Bordit

Në cilësi të dëshmitarit, Gjykata gjithashtu ka ftuar Menagjerin e KRM-ës 'Ambienti' në Pejë Nexhat Abdullahun, i cili deklaroi se është e vërtet që nuk e ka njoftuar fare këtu të pandehurin Lytfi, nga se AKK-ëja nuk e ka njoftuar për njëri një të tillë

Gjykata pas vlerësimit të Kërkesës Kundërvajtëse, deklaratës së të pandehurit, deklaratës së dëshmitarit, njoftimit zyrtar të AKK-ës, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjenë se në rastin konkret ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësin kundërvajtëse të të pandehurit Lytifi.

Gjykata me provat e proceduara nuk ka gjetë se i pandehuri ka qenë i informuar për obligimin e deklarimit të pasurisë, kështu që në prezencën e këtyre rrethanave, e duke pas parasysh se i pandehuri ka qenë në lajthim faktik, e cila është bazë për përjashtimin e përgjegjësisë kundërvajtëse. Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet nga neni 198 par.1.pika 2 të LK-ës, në bazë të së cilës ka vendos sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi

**Vendosur në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Pejë
Regj.6-10327/11, dt. 21.11.2011**



**Gjyqtari
Feti Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë e nëpërmes të kësaj gjykate, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi